



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERA VE
Komisioni i Shqyrtimit te Kerkesave

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tirane, Tel. 04 222 4996 Fax. 04 227 0627 – www.moc.gov.al

Nr. 6382/10 Prot.

Tirane, me 10 2011

AKT REFUZIMI

Arsyet e refuzimit per subjektin "LENGARICA & ENERGY", LC 9701

Pas shqyrtimit te aplikimit te shoqerise "LENGARICA & ENERGY" ne Komisionin e Shqyrtimit te Kerkesave per pajisje me Leje Mjedisore Nr. 33, date 22.09.2011, u vendos te refuzohet kerkesa per zhvillimin e aktivitetit "Ndertim HEC-i" ne lumin Lengarica, Komuna Petran, rrethi Permet, Qarku Gjirokastrer per arsyet e mepostme:

- Ne dokumentacionin e paraqitur mungojne percaktimet me koordinata te veprave te projektit;
- Nga planimetritet e projektit konstatohet se ai do zbatohet brenda siperfaqes se Parkut Kombetar "Bredhi i Hotoves-Dangelli" shpallur me VKM nr. 1631, date 17.12.2008 "Per shpalljen "park kombetar" te ekosistemit natyror Bredhi i Hotoves-Dangelli me siperfaqe te zgjeruar I cili mbrohet me ligji;
- Gjithashtu ne zonen e projektit gjendet edhe Kanioni i Lengarices i cili eshte shpallur me VKM Nr.676, date 20.12.2002 "Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare". Zbatimi i ketij projekti shkakton ndikime negative te konsiderueshme dhe demtimin e Kanionit, gje qe bie ndesh me parashikimet e ligjit nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" dhe ndryshimet perkatese;
- Devijacioni i rrjedhes natyrale do te kene gjithashtu ndikim negativ te konsiderueshem edhe ne burimet termale ne fund te kanionit, prane Benjes.

Projekti ne variantin e paraqitur bie ndesh me legjislacionin mjedisor ne fuqi prandaj per te nuk mund te miratohet leja e mjedisit. Sa me siper ndertimi i HEC-it mund te kryhet vetem nese do te shfrytezohen ujerat ne pjesen e poshtme te kanionit sapo kalojne burimet termale te Benjes.

Arben DEMETI

ZEVENDESMINISTRI

